



RREGULLORE PËR GJYKIMIN DISIPLINOR PROFESIONAL

PJESA E PARË PËRKUFIZIME DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Rregulli 1 BAZIMI DHE OBJEKTI

Gjykimi Disiplinor Profesional dhe Rregullorja e Komisionit Kombëtar të Gjykimit Disiplinor Profesional janë bazuar në Ligjin Nr. 127/2014, datë 02.10.2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe në Statutin e U.S.SH.-së.

Mbështetur në këto akte normative, Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë (U.S.SH.) – ndërmerr veprime dhe bën **GJYKIMIN DISIPLINOR PROFESIONAL** të anëtarëve të tij në këto raste:

1. Kur kompetenca apo performanca profesionale e një stomatologu ka mangësi serioze;
2. Kur ka një akuzë për mjekim të pakujdesshëm apo sjellje profesionale të padenjë.
3. Kur një stomatolog është dënuar nga organet e drejtësisë;
4. Kur për shkak të gjëndjes së tij shëndetësore, stomatologu bëhet i paaftë dhe i papërgjegjshëm për të ushtruar profesionin;
5. Kur stomatologu refuzon të zbatojë vendimet, urdhërat, udhëzimet që dalin nga Urdhri i Stomatologut, apo refuzon paraqitjen e tij/e saj kur i kërkohet në cilado instancë e Urdhrit;
6. Kur stomatologu ose ndihmësstomatologu punon në kushtet kur i ka përfunduar afati i lejes së ushtrimit të profesionit apo s’është i fare licensuar;
7. Në rastet kur stomatologu ose subjekti juridik që përfaqëson pronësinë e klinikës zhvillon reklamë në të gjitha llojet e mas-mediave me ççmime konkrete të tarifave në shërbimin dentar.

Rregulli 2 PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Gjykimi Disiplinor Profesional është i pavarur, i paanshem, objektiv dhe i drejtë;

2. Të gjitha ankesat e mbërritura në USSH, pa përjashtim i nënshtrohen shqyrtimit dhe vendimarrjes në kryesinë e Këshillit Rajonal;
3. a) I nënshtrohen verifikimit paraprak dhe eventualisht veprimit disiplinor vetëm ankesat me shkrim, të firmosura nga ankuesi apo përfaqësuesi zyrtar i institucionit që bën denoncimin, si dhe konstatimet e sinjalizuara nga mas-media;
b) Nisma për proces disiplinor fillon edhe për rastet kur Këshilli i Qarkut ose aparati qëndror i Urdhrit nëpërmjet inspektimit konstaton shkelje të Statutit dhe të Kodit të Etikës;
c) Inspektimi hap dosje të vecantë për rastin evident dhe ia paraqet atë Kryesisë së Qarkut të U.S.SH.-së. Kryesia e Qarkut kur e shikon të arsyeshme ia kalon vendimin Komisionit të Disiplinës;
4. Urdhri i Stomatologut pranon dhe ndërmerr veprime disiplinore vetëm për çështje që i përkasin Misionit dhe atributëve të tij të ligjshme;
5. Gjykimin në seancën dëgjimore në Komisionin Disiplinor i nënshtrohen rastet për të cilat vendos kryesia e Këshillit Rajonal, si dhe ato që apelojnë nga denoncuesi apo palët në gjykim;
6. Ankesat gojore nuk mund të bëhen objekt për *Veprim Disiplinor*, me përjashtim të rasteve kur mund të objektivizohet vërtetësia e tyre. Ankesat gojore merren në konsideratë dhe vlerësohen dhe sipas rastit e rëndësisë së tyre, personi apo personat e denoncuar thirren veçmas ose në prani të drejtuesit shëndetësor, vihen në dijeni për ankesën, u tërhiqet vëmëndja dhe paralajmërohen për çështjet e ngritura ndaj tyre;
7. Palët në gjykim kanë të drejtë të asistohen për mbrojtje ose të përfaqësohen në gjykim nga një person, të cilin e caktojnë vet. Ky person për stomatologët duhet të jetë stomatolog mundësisht i të njëjtit specialitet, kurse për palën tjetër mund të jetë stomatolog ose avokat i licencuar;
8. Kur Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional i shkallës së parë, apo të dytë e cilëson të domosdoshme prezencën e palëve në seancë dëgjimore, atëherë ata janë të detyruar të jenë prezent;
9. Juristi i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të stomatologut kontrollon zbatimin dhe respektimin e kësaj Rregulloreje, jep udhëzime dhe merr masa për të rregulluar të metat e konstatuara. Për probleme që e konsideron të nevojshme, informon Presidentin e Këshillit Kombëtar të U.S.SH.-së;
10. Kur çështja e ankimuar i është referuar organeve të drejtësisë, Urdhri i Stomatologut kryen të gjitha veprimet konform kësaj rregulloreje duke krijuar të plotë Dosjen e Çështjes. Nga ky moment, pezullohet Veprimi Disiplinor për të vazhduar me tej nëse ka arsye, pas marrjes së vendimit të formës së prerë nga organet e drejtësisë;
11. Në rastet kur nuk zbatohet procedura e sanksionuar në këto rregullore, Zyra Juridike pranë administratës qëndrore do ta anulojë vendimin pa e kaluar në Komisionin Kombëtar të Etikës (Apelit)..

Rregulli 3

SHKALLËT E GJYKIMIT DISIPLINOR PROFESIONAL

Gjykimi profesional kryhet në dy shkallë:

1. **Shkalla e parë** organizohet e kryhet pranë Këshillit Rajonal dhe zhvillohet në dy faza:
 - A. Hapja e Dosjes dhe shqyrtimi i çështjes nga Kryesia e Këshillit Rajonal.
 - B. Gjykimi në seancë dëgjimore nga Komisioni Disiplinor pranë Këshillit Rajonal. Komisioni Disiplinor për shkallën e parë të gjykimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë: 2 (dy) stomatologë dhe 1 (një) jurist.
2. **Shkalla e dytë** e gjykimit profesional (e apelit) organizohet e kryhet pranë Këshillit Kombëtar. Komisioni Disiplinor i shkallës së dytë përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, 6 (gjashtë) stomatologë dhe 1 (një) jurist.

Në të dy shkallët e gjykimit, kryetari i Komisionit është stomatolog. Në rastet kur çështja që gjykohet ka probleme apo komplikimet janë edhe nga sektori i mjekësisë së përgjithshme, atëherë në trupën e gjykimit atashohen edhe mjekë të përgjithshëm-specialistë.

Rregulli 4

KOMISIONET E GJYKIMIT DISIPLINOR PROFESIONAL

1. Komisionet e Gjykimit Disiplinor Profesional të *shkallës së parë* ngrihen pranë çdo Këshilli Rajonal dhe janë në funksion vetëm të këtij Këshilli. Këto komisione përbëhen nga 7 (shtatë) anëtarë prej të cilëve 6 (gjashtë) mjekë dhe 1 (një) jurist. Për çdo çështje në gjykim vetëm 3 (tre) nga këta, 2 (dy) stomatologë dhe 1 (një) jurist caktohen në përbërje të Komisionit të Gjykimit Disiplinor Profesional.
2. Komisioni Kombëtar i Gjykimit Disiplinor Profesional i *shkallës së dytë* ngrihet pranë Këshillit Kombëtar dhe është në funksion të këtij këshilli. Ky Komision përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, prej të cilëve 8 (tetë) stomatologë dhe 1 (një) jurist. Për çdo çështje në gjykim të shkallës së dytë, vetëm 5 (pesë) nga anëtarët e këtij komisioni, 4 (katër) stomatologë dhe 1 (një) jurist, caktohen në përbërjen e Komisionit të Gjykimit Disiplinor Profesional.

Rregulli 5

PËRZGJEDHJA DHE EMËRIMI I KOMISIONERËVE

Kandidatët për anëtarë të Komisioneve të Gjykimit Disiplinor Profesional të shkallës së parë përzgjidhen nga kryesia e Këshillit Rajonal dhe miratohet me vendim të atij Këshilli.

Lista e Kandidatëve për anëtarë të Komisionit Kombëtar të Gjykimit Disiplinor Profesional të shkallës së dytë (Apeli) përzgjidhet nga Aparati Qëndror i Këshillit Kombëtar, dhe miratohet me vendim të Këshillit Kombëtar, me votim të hapur, me shumicë të thjeshtë të votave.

Kandidatët juristë për anëtarë të Komisioneve të Gjykimit Disiplinor Profesional, preferohet të përzgjidhen nga juristë të administratës së institucioneve

shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë ose të ISKSH, ose ne pamundësi, nga dhoma e avokatëve të cilët të jenë të licencuar, në bashkëpunim e mirëkuptimin me këto institucione. Kandidatët për anëtarë të Komisioneve të të dyja shkallëve u merret miratimi përpara se të propozohen.

Rregulli 6 **KRITERET E PËRZGJEDHJES**

Kandidaturat për anëtarë të Komisioneve të Gjyimit Disiplinor Profesional përzgjidhen duke u orientuar nga këto kritere:

1. Përvojë jo më pak se 5 vjet në ushtrimin e profesionit (për stomatologët e përgjithshëm) dhe mbi 3 vjet pune për mjekët e specializuar;
2. Prestigj dhe reputacion etiko-moral dhe profesional;
3. Mundësisht të ketë përvojë në veprimtari administrative ;
4. Ndalohet kategorikisht të zgjidhen në Komisionet e Gjyimit Disiplinor ata persona që gjatë pesë viteve të fundit janë ndëshkuar për shkelje të ndryshme në ushtrimin e profesionit, apo çështje të tjera penale nga organet e drejtësisë;
5. Ndalohet kategorikisht që në Komisionet e Gjyimit Disiplinor të zgjidhen persona që janë në funksione drejtuese në administratën e institucioneve shtetërore apo në forume partiake të çfarëdo niveli;
6. Anëtarët e Komisionit Kombëtar të Etikës të kenë mbi 15 vjet punë (të licensuara).

Rregulli 7 **KOHËZGJATJA E MANDATIT NË KOMISIONIN E GJYIMIT DISIPLINOR PROFESIONAL**

Mandati i anëtarit të Komisioneve në të dyja shkallët e gjyimit është 4 (katër) vjet, me të drejtë riemërimi.

Rregulli 8 **LIRIMI I PARAKOHSHËM NGA DETYRA I ANËTARIT TË KOMISIONEVE TË GJYIMIT DISIPLINOR PROFESIONAL**

Lirimi i parakohshëm nga detyra e anëtarit të Komisionit bëhet kur:

- a) Kërkon vetë dorëheqjen;
 - b) Dënohet me vendim të formës së prerë për vepra penale ose kundravajtje administrativo-disiplinore;
 - c) Shpërdoron detyrën në Komision ose i shmanget gjyimit objektiv;
 - d) Mungon tre herë, pa shkaqe të arësytuar, në seancat e gjyimit profesional;
 - e) Paaftësohet ose invalidizohet për arsye shëndetësore;
- Propozimi për largimin e parakohshëm bëhet nga Kryesia e Keshillit Rajonal, ose nga Aparati Qëndror i Këshillit Kombëtar, (përkatësisht për shkallën e parë dhe të dytë).

Largimi bëhet me vendim të Këshillit Kombëtar për anëtarët e Komisionit Kombëtar të Gjyimit Disiplinor Profesional të shkallës së dytë (Apeli), dhe të Këshillit Rajonal për anëtarët e Komisioneve të shkallës së parë të gjyimit.

Rregulli 9

BURIMET DHE PRANIMI I ANKESAVE

Ankesat ndaj stomatologëve mund të vijnë nga:

- a) Pacientë, familjarë e të afërm të pacientëve, qytetarë të tjerë;
 - b) Anëtarë të Urdhrit të Stomatologut ;
 - c) Drejtues të institucioneve shëndetësore ose social-shëndetësore;
 - d) Organe të administratës publike ;
 - e) Ministri i Shëndetësisë dhe Presidenti i Këshillit Kombëtar të U.S.SH.-së.
- Ankesa e mbërritur pranohet nga Këshilli Rajonal të cilit i përket stomatologu i paditur, dhe shqyrtohet në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë Rregullore.

Rregulli 10

NGRITJA E KOMISIONEVE DISIPLINORE

Përbërja e Komisionit Disiplinor, si dhe Kryetari i Komisionit caktohet:

- a) Për shkallën e parë nga kryesia e Këshillit Rajonal përkatës ;
 - b) Lista e anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Etikës projektohet në konsultim me Bordin Këshillimor të Presidentit dhe miratohet në Këshill Kombëtar.
- Ngritja e Komisioneve për shkallën e parë të gjyimit urdhërohet nga Presidenti i Këshillit Rajonal dhe në mungesë të tij nga Zëvendësi, ndërsa për shkallën e dytë thirrja e Komisionit urdhërohet nga Presidenti i Këshillit Kombëtar, Zv.Presidenti ose nga një person i autorizuar.

Rregulli 11

NDALIMI PËR PJESËMARRJE NË KOMISIONET DISIPLINORE

- Ndalohet pjesëmarrja në Gjykimet Disiplinore si dhe në ekipet ndihmëse, e personave që kanë lidhje farefisnore apo çfarëdo lidhje tjetër shoqërore a miqësore me personat në gjykim. Mosdeklarimi i tyre sjell pezullimin e gjyimit dhe anulimin e vendimit kur gjykimi ka përfunduar. Ndaj personit mbahet qëndrim dhe i bëhen ngarkim shpenzimet e gjyimit.

Rregulli 12
SALLA E SEANCËS DËGJIMORE DHE POZICIONET VENDORE TË ANËTARËVE

Sallat për zhvillimin e seancave dëgjimore zgjidhen të përshtatshme, për të siguruar një gjykim të qetë dhe dinjitoz. Këshilli nën kujdesin e të cilit kryhet gjykimi, merr masa për vendosjen e Komisionit dhe të të pranishmëve të tjerë.

Rregulli 13
VEPRIMI DISIPLINOR PËR ANËTARËT E U.S.SH-së ME SHTETËSI TË HUAJ

Stomatologët shtetas të huaj, që e ushtrojnë profesionin e tyre kudo brenda territorit të Shqipërisë, kur bëhen objekt për veprim disiplinor, u nënshtrohen të gjitha procedurave të gjykimit sikurse shtetasit shqiptarë. Për masat e marra njoftohet organi homolog i vendit të tyre (Urdhri/Dhoma/Shoqata, etj).

PJESA E DYTË

PROÇESET E GJYKIMIT DISIPLINOR

Rregulli 14
KOMPETENCAT VENDIMARRËSE TË KRYESISË SË KËSHILLIT RAJONAL DHE KOMISIONEVE DISIPLINORE

Kur sipas fakteve dhe provave të administruara në Dosjen e çështjes vërtetohen shkelje të akteve normative mbi të cilat bazohet kjo Rregullore, vendoset për një nga masat ndëshkimore si më poshtë:

A- Kryesia e Këshillit Rajonal ka kompetencë të vendosë për:

- a) Mbylljen e çështjes;
- b) Këshillim;
- c) Relatimin e çështjes për gjykim disiplinor profesional.

Të gjitha këto dokumentohen me shkrim në dosjen personale të mjekut dhe në Regjistrin e informatizuar.

B- Komisionet e Gjyimit Disiplinor Profesional të shkallës së parë, kanë këto kompetenca:

- a. Lë në fuqi vendimet e Kryesisë së Këshillit Rajonal;
- b. Vërejtje me shkrim;
- c. Vërejtje me paralajmërim për heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit;
- d. Pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologut deri në 3 (tre) vjet.
- e. Propozim për shkarkim nga funksionet drejtuese të institucioneve shëndetësore;

- f. Gjobë nga 15.000 – 100.000 lekë;
- g. Heqje e përkohshme e Liçensës për ushtrimin e profesionit për një periudhë deri në 3 vjet.
- h. Detyrim për rikualifikim profesional dhe për studime plotësuese.

C- Komisioni Disiplinor i shkallës së dytë (i Apelit) ka këto kompetenca:

1. Lë në fuqi Vendimin e Komisionit Disiplinor të Shkallës së Parë;
2. Rikthen çështjen për ri-gjykim në Komisionin Disiplinor të Shkallës së parë;
3. Hedh poshtë Vendimin e Komisionit Disiplinor të shkallës së parë dhe merr një Vendim të ri për masat disiplinore në përputhje me Ligjin “Për Urdhrin e Stomatologëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullin 14 të kësaj Rregulloreje.

Rregulli 15

EKIPET NDIHMËSE NË VEPRIMET DISIPLINORE

Për çdo rast të ankimuar pranë Këshillit Rajonal caktohet ekipi ndihmës me përbërje:

1. Një ose dy stomatologë me detyrën e verifikimit paraprak dhe të **Relatuesit**.
2. Një **sekretar** i Komisionit Disiplinor, për seancat dëgjimore.
3. Ekspertë mjekësorë, mjeko-ligjorë apo ligjorë, në varësi të përmbajtjes dhe specifikës së çështjes së ngritur për gjykim.

Ekipet ndihmëse, për shkallën e parë të gjykimit caktohen nga kryesia e Këshillit Rajonal, ndërsa për shkallën e dytë (*kur kërkohen të dhëna shtesë*), nga Aparati Qëndror i Këshillit Kombëtar.

1 – GJYKIMI NË SHKALLË TË PARË

A. FILLIMI I VEPRIMIT DISIPLINOR NË KËSHILLIN RAJONAL

Rregulli 16

RRADHA E VEPRIMEVE NË KRYESINË E KËSHILLIT RAJONAL

- a. Ankesa apo kërkesa e mbërritur, protokollohet dhe regjistrohet në Regjistrin e posaçëm të ankesave. Kryesia e Këshillit Rajonal:
- b. Takon stomatologun e paditur dhe e pyet për fakte e të dhëna plotësuese, si dhe e njeh atë me:
 - Ankesën e ardhur në adresë të tij duke i dorëzuar një kopje të saj ;
 - Proçedurat që kryhen për gjykimin disiplinor profesional ;
 - Detyrimin që brenda 15 ditëve nga ky moment të paraqesë mbrojtjen e tij me shkrim, si dhe dëshmi e dokumente kundërthënëse për ankesën e paraqitur ;
 - Të drejtën për tu asistuar për mbrojtje ose për tu përfaqësuar në gjykim nga një mjek mundësisht i të njejtit specialitet, si dhe me detyrimin për të qenë prezent

- në seancë dëgjimore kur Komisioni i Gjykimit e cilëson të domosdoshme prezencën e tij;
- c. Merr takim me drejtuesin kryesor të institucionit shëndetësor publik apo privat për t'i njoftuar ankesën dhe për të bashkëpunuar në procesin e plotësimit të informacionit dhe verifikimit paraprak;
 - d. Thërret në takim në zyrën e Këshillit palën ankuese për verifikim dhe informacion plotësues, pretendimet, kërkesat, synimet e saj dhe gadishmërinë për tu ballafaquar me palën tjetër;
I kërkohet nëse ka ose jo dëshmitarë dhe materiale të tjera që vërtetojnë dhe sqarojnë për çështjen e ankimuar dhe a i qëndron ankesës së bërë;
 - e. I bën të ditur procedurën disiplinore dhe të drejtën për tu asistuar ose përfaqësuar në gjykim nga një stomatolog, ose avokat i licencuar, si dhe detyrimin për të qenë prezent në seancë dëgjimore kur Komisioni i Gjykimit e cilëson të domosdoshme prezencën e tij;
 - f. Cakton stomatologun Verifikues-Relatues, e njeh me detyrën që do të kryejë dhe për të mos u penguar në punën e tij, e pajis me autorizimin përkatës nga Këshilli;
 - g. Gjatë gjithë akteve të marrjes së informacionit (të çdo lloji) është e këshillueshme që ato të dokumentohen dhe të arshivohen (në çdo lloj mënyre).

Rregulli 17

DETYRAT PARAPRAKE TË RELATUESIT DHE RRADHA E VEPRIMEVE PËR VERIFIKIM

- Relatuesi ka detyrë të bëjë verifikimin paraprak të saktë dhe objektiv të çështjes për gjykim. Për të përmbushur detyrën e tij, Relatuesi kryen sipas rradhës:
- a. Takim me stomatologun e paditur, të cilin e njeh përsëri me ankesën ndaj tij dhe i kërkon të paraqesë me shkrim sqarimet dhe mbrojtjen e tij ;
 - b. Takon drejtuesit kryesorë të institucionit apo organit shëndetësor publik apo privat ku punon stomatologu i paditur dhe merr të dhëna rreth çështjes së ngritur, si dhe stomatologun në fjalë;
 - c. Bllokon dokumentat klinike apo zyrtare me procesverbal ku i shqyrton ato.
 - d. Pyet dëshmitarë, kolegë e personel mjekësor apo persona të tjerë të vendit ku punon stomatologu i paditur. Dëshmitë e marra dokumentohen me shkrim dhe firmosen nga personat e intervistuar;
 - e. Në përfundim të fazës verifikuese harton "**Raportin për Verifikimin Paraprak të Çështjes** "____" Verifikimi paraprak për instancën e parë të shqyrtimit në Këshillin Rajonal, përfundon jo më vonë se 30 ditë nga mbërritja e ankesës apo kërkesës me shkrim në Këshillin Rajonal.

Rregulli 18

MBLEDHJA E KRYESISË SË KËSHILLIT RAJONAL DHE VENDIMMARRJA

Në përfundim të verifikimit paraprak, nën kujdesin e Presidentit të Këshillit Rajonal, Raporti mbi Verifikim Paraprak të çështjes dhe veprimet e tjera të dokumentuara me

shkrim, nënshkruhen nga anëtarët e Kryesisë së Këshillit dhe inventarizohen të numërtuara me protokoll duke krijuar Dosjen e Çështjes « _____ » për Kryesinë e Këshillit Rajonal.

Anëtarët e Kryesisë njoftohen për datën dhe orën e mbledhjes jo më pak se 15 ditë para zhvillimit të saj. Gjatë këtyre ditëve, në zyrat e këshillit rajonal ata njihen me raportin e Verifikimit Paraprak dhe materialet e tjera të Dosjes.

Në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit Rajonal: * Janë të pranishme dhe ballafaqohen palët në proces.

- a) Presidenti prezanton palët e pranishme pastaj ia jep fjalën Relatuesit i cili lexon Raportin mbi Verifikim Paraprak dhe njih të pranishmit me materialet e administruara në Dosje.
- b) Relatuesi dhe palët në proces u përgjigjen pyetjeve të të pranishmëve.
- c) Pasi çështja është sqaruar dhe shqyrtuar përfundimisht, palëve në gjykim u kërkohet largimi.
- d) Presidenti i parashton Kryesisë opinionin e eksperteve dhe të verifikuesit, si dhe propozimin e tij. Kryesia bazuar në këto opinione, fakte dhe prova të administruara në dosje vendos për masat disiplinore të parashikuara në gërmën "A" të rregullit 14 të kësaj Rregulloreje. Vendimi i Kryesisë merret me konsensus ose me votim të hapur me shumicë të thjeshtë votash.
- e) Presidenti i Këshillit u komunikon palëve vendimin, si dhe të drejtën e ankimit brenda 10 (dhjetë) ditëve kundër këtij Vendimi në kryesinë e Këshillit Rajonal me kërkesën për gjykim në Komisionin Disiplinor Profesional të shkallës së parë, të cilën e dorëzon me shkrim jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit.

* Zhvillimi i mbledhjes pasqyrohet me hollësi në Proçesverbalin i cili arkivohet në Këshill.

* Kur Kryesia vendos relatimin e çështjes në shkallën e parë të gjykimit, dosja e çështjes me vendimin e kryesisë, e firmosur nga Presidenti i Këshillit Rajonal vihet në dispozicion të anëtarëve të Komisionit të Gjykimit Disiplinor jo më vonë se 20 ditë nga marrja e vendimit.

Rregulli 19

B. ZHVILLIMI I SEANCËS DËGJIMORE TË SHKALLËS SË PARË TË GJYKIMIT

Proçesi disiplinor i shkallës së parë të gjykimit organizohet dhe kryhet nën kujdesin e Presidentit dhe të kryesisë së Këshillit Rajonal, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen deri në përfundim të tij.

Anëtarët e Komisionit Disiplinor dhe të Ekipit Ndihmës lajmërohen për datën dhe orën e seancës dëgjimore dhe çështjen që do të gjykohet, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, para datës së caktuar për seancën dëgjimore. Gjatë këtyre ditëve në zyrën e Këshillit Rajonal ata njihen me raportin mbi Verifikimin Paraprak të Çështjes dhe me materialet e dosjes në tërësi.

Nëse, nga anëtarët e Komisionit, gjatë studimit të Dosjes kërkohen të dhëna të tjera përveç atyre që përmbahen në Dosje, verifikimi paraprak si dhe Gjykimi Disiplinor i shkallës së parë, kryhen jo më vonë se 60 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës për gjykim.

Seanca dëgjimore zhvillohet në 3 (tre) faza:

a) Faza e hapur; b) Faza e mbyllur dhe vendimmarrja; c) Shqiptimi i vendimit.

a. Faza e hapur

1. Kryetari hap zyrtarisht seancën dëgjimore. Paralajmëron palët dhe të pranishmit të respektojnë rregullat për zhvillimin normal të seancës. Në të kundërt seanca ndërpritet dhe shkaktarit i bëhen ngarkim shpenzimet e saj. Pastaj, Kryetari vazhdon duke komunikuar shprehimisht se:

" Ankuesi/kërkuesi _____ ka paditur në Këshillin Rajonal të _____
mjekun _____ për _____"

Në bazë e për zbatim të Ligji 8615 dt. 01.06.2000 "Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë dhe të Rregullores për Gjykimin Disiplinor Profesional, deklaroj të hapur seancën dëgjimore për Gjykim Profesional të çështjes së sipërpërmendur.

2. Sekretari i seances paraqet të dhënat e dosjes, duke lexuar titullin e secilit dokument dhe duke ia bërë të dukshëm atë Komisionit dhe palëve.
3. I jepet fjala Realtuesit i cili lexon Raportin mbi Verifikimin Paraprak të Çështjes.
4. Kryetari i seancës dëgjimore i drejton pyetje në fillim mjekut të paditur, pastaj ai pyet edhe palën tjetër (ankuesin/en).
5. Kryetari u kërkon anëtarëve të Komisionit nëse kanë pyetje për palët në gjykim, si dhe për ekspertët.
6. Para mbylljes së seancës, u jepet fjala palëve në gjykim, në fillim asaj të paditur, pastaj palës tjetër, nëse kanë kërkesa për sqarime dhe shpjegime të tjera.
7. Komisioni tërhiqet për të marrë Vendimin.

* Nëse gjatë seancës lind kërkesa për verifikime plotësuese, Komisioni vendos ndërprerjen e seancës duke e pasqyruar këtë në Proçesverbal i cili firmoset nga Komisioni. Seanca tjetër zhvillohet jo më vonë se 30 dite nga ndërprerja e kësaj seance.

b. Veprimet në fazën e mbyllur dhe vendimmarrja

* Seanca vazhdon pa praninë e personave të tjerë përveç Komisionit Disiplinor.

- 1- Kryetari u kërkon anëtarëve të Komisionit Disiplinor të diskutojnë dhe të shprehin mendimin e tyre për masën ndëshkuese duke e argumentuar atë.
- 2- Duke marrë në konsideratë edhe mendimet e parafolësve, Kryetari propozon masën ndëshkimore.

2 – GJYKIMI NË SHKALLËN E DYTË (APELI)

Proçesi disiplinor i shkallës së dytë të gjykimit kryhet nën kujdesin e Presidentit dhe Aparatit Qëndror të Këshillit Kombëtar, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen deri në përfundim të tij.

Verifikimi paraprak, nëse kërkohen të dhëna të tjera shtesë, si dhe Gjykimi në seancë dëgjimore të Apelit, kryhen jo më vonë se 60 ditë nga dita e mbërritjes së kërkesës për rekurs.

Përveç rasteve kur çështja dërgohet për ri-gjykim në shkallën e parë, të gjitha vendimet e tjera të gjykimit të shkallës së dytë (Apelit) janë përfundimtare dhe të formës së prerë.

Për masat disiplinore të parashikuara në shkronjat (e), (f) dhe (g) të shkronjës B të rregullit 14 të kësaj rregulloreje, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës, jo më vonë se 15 ditë nga dita e shqiptimit të vendimit të Komisionit Disiplinor të Apelit.

Rregulli 20

VEPRIMET PËR GJYKIMIN NË APEL

1. Për çështjen e mbërritur në Apel njoftohet Presidenti i Këshillit Kombëtar. Njoftohet njëkohësisht edhe pala e paditur të cilës i jepet kopje e kërkesës për apelim dhe i kërkohet të sjellë brenda 10 ditëve kundër argumentat e veta;
2. Tërhiqet Dosja e Gjykimit të shkallës së parë, e cila dorëzohet me proçesverbal në Këshillin Kombëtar;
3. Kryhen proçedurat për caktimin e Komisionit Disiplinor. Si *Ekip Ndhmës* shërben ai i shkallës së parë;
4. Juristi i Këshillit Kombëtar cakton ditën dhe orën e zhvillimit të seancës për të cilën njoftohen pjesëmarresit, jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë përpara zhvillimit të saj;
5. Gjatë kësaj periudhe, anëtarët e Komisionit Disiplinor të çështjes njihen me dosjen në zyrat e Këshillit Kombëtar;
6. Relatuesi ndërmerr veprime verifikuese plotësuese për probleme që i kërkohen nga Komisioni apo Ekspertët;
7. Aparati Qëndror i Këshillit Kombëtar merr masat për sallën dhe krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e séances;
8. Në ndihmë të gjykimit vlen literatura e 5 viteve të fundit (për arësye mbrojtjeje ose akuze) nga dita e gjykimit.

Rregulli 21

MBLEDHJA E KOMISIONIT PËR SEANCËN DËGJIMORE

Seanca dëgjimore e Apelit pasqyrohet në Proçesverbal duke respektuar dhe zbatuar të njëjtat rregulla si në shkallën e parë të gjykimit (Rregulli 19) dhe zhvillohet në 3 (tre) faza :

A-Seanca dëgjimore e hapur ; B-Seanca dëgjimore e mbyllur (vendim-marrja) ; C-Shqiptimi i vendimit.

A. Seanca dëgjimore e hapur Zhvillimi i seancës :

1. Kryetari i Komisionit Disiplinor deklaron hapjen e seancës dëgjimore të çështjes « _____ » të paraqitur nga pala ankuese Z.____ ndaj Vendimit Nr.____, datë.____ të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë____, për masën ndëshkimore____ të akorduar ndaj stomatologut_____.
2. I jepet fjala Relatuesit, i cili lexon pretendimet e palës ankuese ndaj vendimit Nr.____, datë _____, të Komisionit të Gjykimit Disiplinor të shkallës së parë pranë Këshillit Rajonal _____, për masën ndëshkimore _____.
3. I jepet fjala palës tjetër të paditur për të paraqitur kundërargumentet e saj.
4. U jepet me rradhë fjala anëtarëve të Komisionit për të kërkuar sqarime rreth çështjes dhe pretendimeve të palëve në gjykim.
5. U jepet fjala eksperteve dhe specialistëve të ekipit ndihmës.
6. Nesë gjatë zhvillimit të seancës kërkohen verifikime plotësuese, Komisioni vendos ndërprerjen e seancës dhe e pasqyron këtë në procesverbal të firmosur nga Komisioni i Gjykimit Disiplinor. Për këtë veprim njoftohet Presidenti i Këshillit Kombëtar i cili urdhëron kryerjen e veprimeve të mëtejshme. Seanca pasardhëse bëhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga ndërprerja e kësaj seance.
7. Kryetari e deklaron të mbyllur seancën, për të kaluar në procesin e vendimmarrjes në seancë të mbyllur.

B. Seanca e mbyllur (vendimmarrja)

Marrin pjesë vetëm anëtarët e Komisionit të Gjykimit Disiplinor.

1. Kryetari hap diskutimet.
2. U jepet fjala me rradhë anëtarëve të Komisionit, të cilët shfaqin mendimet dhe propozimet e tyre të argumentuara për masën ndëshkimore.
3. Kryetari, duke marrë në konsideratë mendimet dhe argumentat e parafolësve, bën komentet dhe propozimin e tij për masën ndëshkimore.
4. Propozimi i Kryetarit hidhet në votim të hapur përkundrejt propozimeve të tjera alternative. Mbetet në fuqi masa ndëshkimore që ka marrë shumicën e thjeshtë të votave.
5. Plotësohet procesverbali i votimit sipas formatit standard.
6. Kryetari i Komisionit plotëson vendimin në rubrikat e formatit standard (shtojca 2 e kesaj rregulloreje).

A. Shqiptimi i vendimit

Bëhet në seancë dëgjimore të hapur:

* Kryetari pasi fton të pranishmit të ngrihen në këmbë, lexon tekstin e vendimit të Komisionit Disiplinor dhe njofton palët për datën ku do tu jepet kopja e vendimit. Vendimi firmoset nga anëtarët e Komisionit dhe vuloset.

* Kopje e këtij Vendimi mbahet në Aparatin Qëndror të Këshillit Kombëtar, dërgohet në Këshillin Rajonal dhe u dorëzohet palëve.

PROÇESVERBAL VOTIMI I KD TE APELIT PRANE KËSHILLIT KOMBËTAR

“Sot më _____ në përfundim të gjykimit të shkallës së dytë te çështjes disiplinore ” _____ ” e ankimuar nga z. _____ përkundër Vendimit Nr. _____ dt. _____ të KD rajonal të _____ të US të Shqipërisë, me votim të hapur u vendos që Z. _____ i shpallur me Vendimin e sipërthënë të shkallës së parë **përgjegjës për _____ t'i jepet Përfundimisht Masa Ndëshkimore Disiplinore** : _____, sipas gërmës (_____) të Nenit _____ të Ligjit Nr. 127/2014 dt. 2.10.2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”.

ANËTARËT E KOMISIONIT DISIPLINOR TË APELIT
ANËTAR ANEËTAR ANËTAR ANËTAR ANËTAR ANËTAR
KRYETARI I KD TË APELIT

Rregulli 22

NJOFTIM I INSTITUCIONEVE PËR VENDIMET E GJYKIMIT DISIPLINOR

Vendimi Disiplinor i bëhet i ditur institucionit të përfshirë në çështjen e gjykuar. Në raste me interes të veçantë Vendimi i Komisionit i njoftohet Ministrisë së Shëndetësisë, Këshillave Rajonale të USSH-së dhe institucioneve shëndetësore të vendit.

Rregulli 23

DETYRIMI PËR KALLËZIMIN NË ORGANET E DREJTËSISË

Kur gjatë fazës së verifikimit paraprak të çështjeve ose gjatë seancave dëgjimore janë vënë re elemente që i kalojnë kompetencat e gjykimit profesional të Urdhrit të Stomatologëve,

Presidenti i Këshillit Rajonal të USSH-së detyrohet të njoftojë në rrugë institucionale Organet e Drejtësisë. Për një veprim të tillë Ai njofton dhe merr paraprakisht miratimin e Aparatit Qëndror të Këshillit Kombëtar.

Rregulli 24

MUNGESA E TË PADITURIT NË SEANCË DËGJIMORE

Seanca dëgjimore shtyhet kur mjeku i paditur, i cili është në dijeni se çështja e tij merret në shqyrtim në seancë dëgjimore mungon dhe as perfaqësohet nga personi i autorizuar për arsye të përligjura dhe nëse ka njoftuar paraprakisht mosardhjen dhe arsyen e tij.

Nëse njëra nga palët nuk paraqitet vetë, dhe as përfaqësohet nga personi i autorizuar, pa arsye të përligjura, çështja shqyrtohet në mungesë.

Vlerësimin e rrethanave të mësipërme ka të drejtë ta bëjnë Kryesia e Këshillit përkatës të U.S.SH.-së me kryetarin e seancës dëgjimore, duke hartuar një procesverbal që vendoset në dosje i numërtuar. Për rastet kur është e vërtetuar se mosparaqitja në Komisionin Disiplinor është e qëllimshme, kjo përbën një rrethanë rënduese e cila merret domosdoshmërisht në konsideratë nga Komisioni Disiplinor në shqyrtimin e çështjes së dhënë.

Rregulli 25 **SHLYERJA E MASAVE DISIPLINORE**

Masat ndëshkimore mund të shlyhen vetëm nëqoftëse brenda 1 viti nga dhënia e tyre për shkronjat (b) dhe (c) të shkronjës B dhe brenda 3 vjetësh për (d) dhe (g) të shkronjës B, ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër ndëshkimore.

Rregulli 26 **PJESËMARRJA NË SEANCË DHE KOMUNIKIMI ME MEDIAN**

Për pjesëmarrjen e të ftuarve dhe të publikut në seancën dëgjimore, si dhe për komunikimin me mediat, vendoset për çdo rast në mënyrë të veçantë. Në varësi të shkallës së gjykimit, vendimin e merr kryesia e Këshillit Rajonal ose Aparati Qëndror Ekzekutiv i Këshillit Kombëtar.

Rregulli 27 **SHPËRBLIMI I PJESËMARRJES NË PROÇESET DISIPLINORE**

Të gjithë anëtarët e Komisioneve Disiplinore dhe ekspertët të përfshirë në verifikime dhe procese disiplinore, shpërblehen me honorare nga U.S.SH.-ja, sipas mënyrës dhe tarifave të miratuara nga Këshilli Kombëtar. Kur dërgohen me shërbime jashtë rrethit, ata përfitojnë shpenzime udhëtimi e dietë, sipas tarifave të përcaktuara në Vendimin përkatës në fuqi të Këshillit të Ministrave.

Rregulli 28 **MASAT NDËSHKIMORE** **(konform nenit 36 të statutit të U.S.SH.)**

Komisioni Disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara në seancë dëgjimore. Kur vërtetohet së anëtari ka kryer shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, Ligjit dhe akteve të tjera kodifikuese lidhur me ushtrimin e profesionit, ai e shpall atë fajtor dhe i jep këto masa:
a) Vërejtje me shkrim;

- b) Vërejtje me paralajmërim;
- c) Gjobë, nga 1.000 — 100.000 lekë;
- ç) Propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore.
- d) Pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologut deri në 3 (tre) vjet;
- dh) Përrjashtim i përkohshëm nga Urdhri i Stomatologut për një periudhë deri në 3 (tre) vjet.

Masa ndëshkuese e parashikuar në shkronjën "dh" sjell si rrjedhojë ç'regjistrim nga Regjistri i Stomatologeve të Rajonit dhe ai Kombëtar, si dhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit për afatin e caktuar në Vendimin Disiplinor.

Masat e mësipërme disiplinore mund të shlyhen, në qoftë se brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre për shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, dhe brenda 3 (tre) vjetësh nga data e dhënies së tyre për shkronjat "ç", "d", dhe "dh", ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

Rregulli 29 **HYRJA NË FUQI**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë nga momenti që miratohet nga Këshilli Kombëtar.

Ky material u përgatit nga Dr.Grej Malo, Gevi Gazheli, Nikoll Deda.

Miratuar me Vendimin **Nr. 22 datë 02/11/2015** të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë.

PRESIDENTI
Dr. Nikoll DEDA